



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Državna Agencija za Zaštitu Ličnih Podataka
National Agency for Protection of Personal Data

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA SHETETERORE PER MBROJTJEN E TE DHENAVE PERSONALE	
DRZAVNA AGENCIJA ZA ZASTITU LICNIH PODATAKA	
NATIONAL AGENCY FOR PROTECTION OF PERSONAL DATA	
ZYRA E ARHIVIT-KANCELARIA ADMINISTRATIVE SERVICE	
Mjesa Orig. No. Orig.	01
Nr. Prot. Pr. Prot.	8
Titulli No. Prot.	02
Data Datum	13/07/2012
PRISHTINE/A	

Nr. 12/12

Datë: 12.07.2012

Në mbështetje të nenit 3 (paragrafi 1), nenit 24 dhe nenit 49 (paragrafi 1. 2) të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 101 (paragrafi 2 ,dhe 3) të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative, Zv. Mbikëqyrësi Kryesor Shtetëror i Agjencisë mori këtë:

V E N D I M

1. Urdhërohet Agjencia për Regjistrim Civil të eliminoj të gjitha parregullsitë e bëra gjatë shqyrtimit të ankesave nga ana e [REDACTED] - Kryesues i Komisionit për shqyrtimin e Ankesave, në ankesat (lëndët) me numër : 118/11/010, 120/11/010, 14/02/011, 127/011.
2. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të lajmërohet me shkrim brenda tetë (8) ditëve lidhur me zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e pranimit.

Arsyetim

Gjatë inspektimit të bërë në Agjencinë për Regjistrim Civil, respektivisht në komisionin për ankesa dhe parashtrësia (në tekstin e mëtejshëm komisioni), nga data 17.05.2012 deri më 07.06.2012, kemi shqyrtuar ligjshmërinë e përpunimit të të dhënave personale nga ana e komisionit në fjalë në periudhën kohore nga muaji Maj i vitit 2010 deri në muajin Shkurt 2012.

Gjate shqyrtimit të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale është konstatuar se janë bërë shkelje të nenit 3 dhe nenit 24 të Ligjit nr. 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nenit 101 (paragrafi 2 ,dhe 3) të Ligjit nr. 02/L-28 për Procedurën Administrative.

Në bazë të vendimit nr. 1040 të datës 07.11.2006 të Ministrisë së Shërbimeve Publike me të cilin emërohet Komisioni i Përhershëm për shqyrtimin e ankesave në Departamentin e Gjendjes Civile me [REDACTED] kryesues i komisionit në përbërje prej tre anëtarëve. Kryesuesi i komisionit ka pasur për detyrë të udhëheq punën e komisionit, të organizoj mbajtjen e takimeve, mbajtjen e shënimeve, mbarëvajtjen e punës dhe hartimin e raporteve.

Gjatë shqyrtimit të ankesave- lëndëve me numër 118/11/010, 120/11/010, 14/02/011, 127/011, kryetari i komisionit [REDACTED] ka organizuar dhe ka nxjerr vendim në praninë e vetëm njërit anëtar të komisionit. Marrja e vendimeve me vetëm një anëtar të komisionit ka krijuar hapësirë që [REDACTED] të vendosë për lëndët e ankimuar, pavarësisht nga vendimi i anëtarit tjetër prezent, duke e ditur që vota e kryesuesit në rast të barazisë së votimit është vendimtare, gjë që e bën [REDACTED] përgjegjës të plotë për shkeljet e evidentuara gjatë shqyrtimit të ankesave.

Në harmoni me nenin 3 (paragrafi 1) të Ligjit 03/L-172 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përpunim i të dhënave personale duhet të bëhet në mënyrë të ligjshme, të paanshme dhe

pa cenuar dinjitetin e subjektit të të dhënave, gjë që nuk ka ndodhur gjatë përpunimit të të dhënave nga ana e komisionit me rastin e shqyrtimit të ankesave të subjekteve të të dhënave Personale.

Komisioni me rastin e shqyrtimit të ankesave-lëndëve 118/11/010, 120/11/010, 14/02/011, 127/011, ka nxjerr vendime në pajtim me "nenin 5.4 të rregullores së UNMIK-ut 2001/19". Neni në fjalë thotë:

Sekretarët e përhershëm të ministrive mbajnë përgjegjësi drejtpërdrejtë ndaj ministrit përkatës. Kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive mbajnë përgjegjësi direkt ndaj ministrit përkatës apo autoriteteve tjera të përcaktuara me ligjin përkatës për themelimin e agjencive ekzekutive. Sekretarët e përhershëm të ministrive dhe kryeshefat ekzekutivë të agjencive ekzekutive janë përgjegjës për:

- (a) Administrimin dhe menaxhimin e gjithëmbarshtëm të ministrisë apo agjencisë ekzekutive dhe për sigurimin e implementimit të funksioneve që u janë besuar atyre;
- (b) Sigurimin e mbikëqyrjes adekuate, dhënien e këshillave të paanshme profesionale dhe të sakta për autoritetin përkatës mbi të;
- (c) Organizimin dhe punësimin e personelit për ministrinë apo agjencinë ekzekutive, si dhe nxjerrjen e urdhërësive administrative dhe vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të asaj ministrie;
- (d) Menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë siguruar ministrisë apo agjencisë ekzekutive;
- (e) Implementimin e politikës jo diskriminuese për personelin e ministrisë apo agjencisë ekzekutive, duke përfshirë edhe përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha fushat dhe nivelet, dhe sigurimin e përbërjes së personelit që reflekton karakterin multi-etnik të Kosovës;
- (f) Punësimin e personelit në ministri apo në agjencinë ekzekutive në bazë të kualifikimit profesional, aftësitë dhe meritat e secilit përmes konkursit të hapur dhe të drejtë.

Komisioni i ka bazuar vendimet e saj në dispozitat ligjore të cilat rregullojnë funksionet dhe përgjegjësit e sekretarëve të përhershëm dhe kryeshefave ekzekutiv, e jo të komisionit në fjalë apo shqyrtimit të ankesave, që do të thotë se vendimet janë bazuar në dispozitat ligjore që nuk rregullojnë punën e komisionit apo shqyrtimit të ankesave.

Në ankesat-lëndët 118/11/010, 120/11/010, 14/02/011, vendimet e nxjerra janë bazuar edhe në nenin 16 (paragrafi 6) të Ligjit për Regjistrat e Gjendjes Civile, dispozita ligjore rregullon regjistrimin në Librat Amëz të të Lindurve, në rastet kur lindja nuk është paraqitur brenda afatit prej 30 ditësh. Dispozita e lartcekur nuk rregullon korrigjimin e datës së lindjes, edhe pse është shfrytëzuar si bazë ligjore nga ana e [REDAKTUAR] në vendimet me numër: 118/11/010, 120/11/010, 14/02/011 dhe 127/011.

E gjithë baza ligjore që ka shërbyer për nxjerrjen e vendimeve nga ana e komisionit nuk rregullojnë çështjet e trajtuara nga vendimet e lartcekura.

Këshillë Juridike

Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa, por mund të hapet konflikt administrativ në Gjykatën kompetente në afatin prej 30 ditësh.

Zv. Mbikëqyrës Kryesor Shtetëror


Mentor Hoxhaj

Vendimi i dërgohet:

- Agjencia për Regjistrim Civil
- Anëtarëve të Këshillit të Agjencisë
- Arkivit të Agjencisë